



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 14 datë 2.3.2022**

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E NDIHMËS  
EKONOMIKE PËR FAMILJET APLIKUESE, TË CILAT NUK JANË  
SHPALLUR PËRFITUESE NGA SISTEMI I PIKËZIMIT DHE QË DO TË  
TRAJTOHEN NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR (6%)  
PËR NDIHMËN EKONOMIKE.**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 2.3.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 21 të Ligjit Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 597 datë 04.09.2019 " Përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", i ndryshuar, kreu IV, pika 1, si dhe bazuar në relacionin e administratës:

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kriterëve për përzgjedhjen e familjeve në nevojë që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar ( 6% ) për ndihmën ekonomike, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.


3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**KRYETAR**

  
**Brisela KADIJA**



Sekretari i Këshillit Bashkiak



**Denis Lesha**

Miratuar me 27 vota

Vota Pro 27

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 9.3.2022

**KRITERET PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR (6%).**

Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT (Total 100)	DOKUMENT KONFIRMUES
1	Familje një prindërore me një ose më shumë fëmijë nën moshë pune	19	Çertifikatë familjare, vërtetim shkollë
2	Familje me 1-2 anëtarë me moshë mbi 50 vjeç secili (pa të ardhura)	17	Çertifikatë familjare
3	Familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara apo invalid pune.	15	Çertifikatë familjare, kopje vendimi nga Kom.mjeko- ligjor
4	Familje të ngujuara për gjakmarje	13	Çertifikatë familjare, vërtetim nga Dr. Raj. e Policisë së Shtetit
5	Familje që kanë k/familjarin në burg apo për kurim brenda vendit	11	Çertifikatë familjare, vërtetim nga institucioni vuajtjes së denimit/ose kom. mjeko-ligjor
6	Familje me 3 apo më shumë fëmijë nën moshë pune	9	Çertifikatë familjare, vërtetim shkollë
7	Familje në proces divorci	7	Çertifikatë familjare, vërtetim nga Gjykata
8	Familje që kanë anëtar madhor të humbur apo zhdukur dhe si të tillë nuk mund të paraqiten tek administratori çdo tre muaj për deklaram	5	Çertifikatë familjare, vendim/vërtetim nga Gjykata
9	Familje të prekura nga fatkeqësite natyrore	3	Çertifikatë familjare, konfirmim nga sektori i emergjencave civile pranë bashkisë
10	Çdo kategori tjetër familje në nevojë e cila nuk mund të plotësojë nevojat bazë jetike	1	Çertifikatë familjare

*Handwritten signature in blue ink.*

